Projekti SIS i Filadelfias:

Regjistrimi për një llogari të Portalit të Prindërve dhe Familjeve

Regjistrimi për një llogari pa një Kod konfirmimi

Nëse tashmë keni një Kod konfirmimi, kaloni në faqen 3.

1. Duke përdorur çdo kompjuter, tabletë ose telefon celular, vizitoni faqen e internetit http://signup.philasd.org në shfletuesin tuaj të internetit.

2. Klikoni **No, I would like to look up my Confirmation Code**.



3. Shkruani informacionin personal të nxënësit tuaj. Nëse keni më shumë se një nxënës, ju duhet vetëm të shkruani informacionin e një nxënësi.



4. Zgjidhni emrin tuaj dhe një numër aktual telefonik nga rekordet e nxënësit tuaj për të kërkuar Kodin e Konfirmimit. Kodi i konfirmimit mund të jepet me mesazh me gojë ose me shkrim.



Shënim: Nëse nuk e shihni emrin tuaj ose një numër telefoni aktual të shënuar, ju lutemi kontaktoni shkollën e nxënësit tuaj.

5. Tani që të keni kodin tuaj të konfirmimit, klikoni në lidhjen për t'u kthyer në Regjistrimin e Llogarisë dhe filloni proçesin.

Regjistrimi për një llogari duke përdorur një kod konfirmimi

1. Duke përdorur çdo kompjuter, tabletë ose telefon celular, vizitoni faqen e internetit http://signup.philasd.org në shfletuesin tuaj të internetit.

2. Nëse keni një kod konfirmimi, klikoni mbi **Yes, take me to Account Registration**.



3. Shkruani mbiemrin tuaj dhe kodin e konfirmimit. Kliko **Next**.



4. Shkruani adresën e emailit tuaj.



Shënim: Ju duhet të keni një adresë emaili personal për t'u regjistruar në një llogari të Portalit Prindër dhe Familje. Nëse nuk keni një adresë emaili, mund të regjistroheni për një llogari email falas duke përdorur Gmail, Outlook, Yahoo ose një shërbim të ngjashëm.

5. Konfirmoni llogarinë tuaj të emailit duke klikuar në lidhjen e dhënë në mesazhin e postës elektronike. Klikoni në lidhjen në internet brenda mesazhit të emailit për të përfunduar regjistrimin tuaj.



6. Pasi të konfirmoni regjistrimin, do të vendosni "Security Setting" tuaj. Zgjidhni një fjalëkalim duke ndjekur udhëzimet e listuara dhe klikoni **Save**.



7. Përgjigjuni tre pyetjeve të sigurisë dhe klikoni **Save**.

8. Hyni në llogarinë tuaj të re me adresën tuaj të postës elektronike dhe fjalëkalimin e ri.